

V E N D I M
Nr.7, datë 25.7.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i “““
Manol Konomi,	Anëtar	i “““
Feti Gjilani,	Anëtar	i “““
Franc Jakova,	Anëtar	i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i “““
Zija Vuci,	Anëtar	i “““
Metush Saraçi,	Anëtar	i “““
Veli Budo,	Anëtar	i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 23.6.1995 dhe 25.7.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S: GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Kryetari zoti Skënder Gjinushi.

O B J E K T I:

1. Detyrimi i Presidentit të Republikës për të kryer dhe respektuar detyrimet që vinë nga përmbajtja e nenit 28 pika 1 e ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”;

2. Deklarimi antikushtetues i manipulimeve dhe shantazheve që bëhen prej Gazetës “Rilindja Demokratike” me dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe prej Kryetarit të Shërbimit Informativ Kombëtar e Presidentit të Republikës me mosveprimin dhe heshtjen e tyre, veprimtari e cila bie ndesh me nenin 15 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate është parashtruar:

Presidenti i Republikës ka vepruar në kundërshtim me pikën 1 të nenit 28 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, për arsye se nuk po ndërmer asnjë veprim për të ndërprerë gjendjen e paligjshme që është krijuar dhe për të garantuar moscënimin e Ligjit Kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”; se nuk e detyron Kryetarin e SHIK-ut, që ka në varësi, të ndalojë çdo lloj manipulimi me dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit; se nuk ndërhyr për të ndaluar Redaksinë e Gazetës “Rilindja Demokratike” për të mos kryer veprime të tilla të paligjshme, dhe, së fundi, nuk nxjerr një dekret për hapjen e këtyre dosjeve.

Gjithashtu është kërkuar që kjo Gjykatë të vendosë detyrimin e Presidentit të Republikës të ushtrojë kompetencat e veta kushtetuese, gjë që do të krijonte mundësi për zbatimin kundër tij të nenit 27 shkronja “a” të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, për shkelje të këtij ligji.

Këto pretendime, që përbëjnë përmbajtjen e objektit të kësaj kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, janë të pabazuara në ligjet kushtetuese për këto arsye :

Në nenin 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, janë përcaktuar në mënyrë taksative kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. As në këtë normë dhe as në dispozitat e ligjeve të tjera kushtetuese, nuk është parashikuar prerogativa e kësaj Gjykate që, me kërkesën e grupeve parlamentare, të ndonjë subjekti tjetër apo edhe me nismën e vet, të marrë në shqyrtim çështjen a i përmbush Presidenti i Republikës detyrat që i janë caktuar me nenin 28 të Ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Sipas kësaj dispozite një nga kompetencat kryesore të Presidentit të Republikës

është të sigurojë respektimin e ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, të ligjeve të tjera dhe të të drejtave e lirive të shtetasve. Këtë kompetencë ai e realizon nëpërmjet organeve të tjera shtetërore përkatëse, të cilat janë ngarkuar me përbushjen e këtij detyrimi kushtetues. Presidenti i Republikës nuk mban përgjegjësi për mosveprim në lidhje me veprimtarinë e organeve të tjera. Po ashtu ai nuk mban përgjegjësi as për ato akte që nxjerr gjatë ushtrimit të kompetencave, të parashikuara në pikat 10, 11 e 19 të nenit 28 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Në bazë të nenit 29 të këtij ligji, aktet që nxjerr Presidenti i Republikës marrin fuqi juridike pasi kundërfirmohen nga subjektet përkatëse të Këshillit të Ministrave, të cilët përgjigjen edhe për përmbytjen e aktit që kundërfirmojnë.

Sipas paragrafit të parë të nenit 31 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, Presidenti i Republikës nuk përgjigjet as për aktet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit të tij, “me përjashtim të rasteve të tradhtisë ndaj Atdheut ose të shkeljes së këtij ligji”. Në paragrafin e dytë të këtij neni është përcaktuar se i vetmi organ ku mund të shtrohet çështja e kësaj përgjegjësie të Presidentit të Republikës është Kuvendi Popullor, i cili e ushtron këtë kompetencë me kërkesën e jo më pak se një të katërtës së deputetëve. Vendimi përkatës mund të merret me votim të fshehtë e me shumicë prej dy të tretash të deputetëve. Vetëm pas marrjes së një vendimi të tillë mund të investohet kjo Gjykatë mbi kundërshtimin e subjektit të caktuar, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, për shqyrtimin e akuzës penale kundër Presidentit të Republikës.

E pabazuar është kërkesa edhe përsa i përket pretendimeve për deklarimin antikushtetuese të manipulimeve e shantazheve të Gazetës “Rilindja Demokratike”, lidhur me dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të Kryetarit të SHIK-ut. Është e vërtetë se mosçenimi i jetës private dhe i dinjitetit të njeriut është një nga të drejtat themelore të tij, të mbrojtura edhe nga neni 15 i Ligjit Kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Por mbrojtja e tyre i është ngarkuar organeve të drejtësisë. Prandaj çdo person që ka pretendime për çenimin e dinjitetit apo të drejtave e lirive të tjera të tij, duhet t’i drejtohet atyre organeve.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenet 24, të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me unanimitet,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë për shkak se çështja nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

MENDIMI PARALEL

Pjesa arsyetuese e vendimit nuk është e plotë.

1. Pretendimet e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, duhej t’i shtroheshin një analize të plotë dhe të gjithanshme.

Një analizë e bazuar në kriteret e sipërme do ta lejonte Gjykatën të dilte me disa konkluzione të rëndësishme, që do të parashtrohen menjëherë më poshtë:

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, i përfaqësuar nga Kryetari i tij, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese, që të deklarohet Presidenti i Republikës përgjegjës për shkelje të normave kushtetuese me objektiv të caktuar:

a) Të mënjanohej zbatimi i procedurës së caktuar nga neni 31, paragrafi i dytë i ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili parashikon mënyrën e vënies në lëvizje të përgjegjësisë penale të Presidentit dhe vënien e Tij në gjendje akuze, ose;

b) Të krijohet, me anën e një vendimi eventualisht pozitiv, baza juridike për zbatimin e kësaj procedure. Këtu lind pyetja: “Çfarë ka parasysh Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate kur shprehet në parashtresën e tij se një vendim i Gjykatës Kushtetuese do të krijonte

mundësi për zbatimin e nenit 27, gërma “a”, dmth., shkarkimin e Presidentit sepse ka shkelur ligjin nr.7491, datë 29.4.1991”?

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, me ose pa qëllim, nuk mbajti parasysh përmbajtjen e paragrafit të dytë të nenit 31. Sipas këtij neni vetëm një e katërta e deputetëve ka të drejtë të verë në lëvizje çështjen e përgjegjësive penale të Presidentit të Republikës, kur konkurrojnë ekstremet e kësaj përgjegjësie dhe vetëm Kuvendi Popullor është kompetent që ta verë Presidentin në gjendje akuze.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, që mbron me forcë përgjegjësinë e Presidentit të Republikës për shkelje të ligjit kushtetues, duhej të ndiqte direkt rrugën që caktohet nga neni 31, paragrafi i dytë, mbasi më parë të bashkonte me kauzën e tij një numër deputetësh të mjaftë për të përfaqësuar një të katërtën e përbërjes së Dhomës së deputetëve.

Gjithashtu, Grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate, nuk ka marrë parasysh edhe përmbajtjen e nenit 24, pika “b” të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, ku thuhet se Gjykata Kushtetuese “shqyrton akuzën penale të ngritur kundër Presidentit të Republikës”.

Në kushtet e përmbajtjes së nenit 24, pika 8, marrja e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese, për deklarimin ose jo të Presidentit të Republikës përgjegjës për shkelje të Kushtetutës, do të përbënte paragjykim të çështjes, shkelje të rëndë të njërit nga parimet më të njohura dhe esenciale të drejtësisë. Kuptohet se kjo nuk është një çështje formale megjithëse edhe forma ka rëndësinë e vet, sepse ajo, siç thuhet është “motra e substancës”.

Mendojmë se duhej të bëhej më mirë dallimi ndërmjet përgjegjësisë së Presidentit për shkelje nga ana e tij “e Ligjit Kushtetues”. - Nocioni “Ligj Kushtetues” është shumë i gjerë dhe i papërcaktuar mirë, sikundër edhe disa dispozita konstitucionale mund të jenë objekt i një kritike të tillë - dhe përgjegjësisë së Presidentit për sigurimin e respektimit “të këtij ligji (të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991), të ligjeve të tjera dhe të të drejtave dhe lirive të shtetasve” (neni 28, pika 1).

Vetëm në rastin e parë shtrohet çështja e përgjegjësisë penale të Presidentit, ndërsa në rastin e dytë kemi të bëjmë me përgjegjësinë penale ose politike (Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi politike) të organeve që me ligj janë të ngarkuar të japin udhëzime për respektimin dhe sigurimin e zbatimit të normave në fjalë. Presidenti i Republikës (neni 31, paragrafi i parë) gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, përgjigjet dhe ka përgjegjësi penale vetëm për rastet e tradhtisë ndaj atdheut dhe të shkeljes së ligjit kushtetues.

2. Mbrojtja e të drejtave, lirisë dhe dinjitetit të njeriut është një nga karakteristikat kryesore të një shoqërie demokratike, një nga parametrat e shtetit ligjor.

Në kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate vihen në dukje disa shqetësime në lidhje me manipulimet dhe shantazhet që bëhen ndaj disa personave si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjykata Kushtetuese nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj këtij problemi të rëndësishëm. Çelja e dosjeve, koha e çeljes dhe shtrirja, janë në diskrecionin dhe në kompetencën ekskluzive të organit ligjvënës, por, përsa kohë që nuk është zgjidhur me ligj kjo çështje, përmbajtjen e këtyre dosjeve e mbulon sekreti absolut dhe këtë duhet ta kenë parasysh organet që janë ngarkuar direkt me ruajtjen e tyre.

Anëtarë

Manol Konomi, Alfred Karamuço, Zija Vuci

Tiranë, më 25.7.1995